



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale që i përket procedimit penal nr. 242, të vitit 2024, në ngarkim të të pandehurit **Besart Logu**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*, parashikuar nga neni 245/1/4 i Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjyimit të shkurtuar. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Atalanta Zeqiraj, Flojera Davidhi dhe Erjon Bani, me vendimin nr. **2**, datë **14.01.2026** vendosi:

- 1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Besart Logu** për veprën penale të *“Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike”*, prashikuar nga neni 245/1 paragrafi 4 i K.Penal, dhe dënimin e tij me 2 vjet burgim.
- 2.** Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e dënimit me 1/3 dhe dënimin e tij me 1 vit e 4 muaj burgim.
- 3.** Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim për të pandehurin **Besart Logu** duke e vënë në provë për një periudhë kohe prej 2 vjet e 8 muaj me kusht që të mos kryej vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës.
- 4.** Në aplikim të nenit 39 të K.Penal, heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatit për një periudhë prej 9 muajsh për të pandehurin **Besart Logu**.
- 5.** Shpenzimet procedurale të kryera gjatë fazës së hetimit dhe ato gjatë gjyimit i ngarkohen të pandehurit.
- 6.** Provat materiale si, provat e mëposhtme:
 - 1 DVD+ËR përgjimi ambiental audio dhe video midis të pandehurit Besart Logu dhe agjentit të koduar me numër kodik ***** të datës 09.12.2024;
 - 1 CD audio dhe video midis të pandehurit Besart Logu dhe agjentit të koduar me numër kodik ***** të datës 13.12.2024, bëhet pjesë e fashikullit të gjyimit.

7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsioni dhe Krimin e Organizuar brenda 15 ditëve, afat i cili fillon të llogaritet nga e nesërmja e marrjes dijeni lidhur me vendimin e arsyetuar.

Tiranë, më datë 16.01.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar